



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokuroria kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 6 korrik 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidenciale

Urdhër për Përgjigje

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hysni Gucatit
Xhonatan Elistan Ris
Hju Bauden

Mbrojtësit të Nasim Haradinajt
Tobi Kadman
Karl Bakli

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE¹ në pajtim me nenin 39(13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 9(5)(a) dhe 76 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara (“Rregullorja”), nxjerr këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 5 korrik 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) parashtroi një njoftim në lidhje me dëshmitarë të mundshëm dhe një kërkesë për të dorëzuar një përmbledhje të informacionit potencialisht shfajësues (“Kërkesa”).²

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

2. Në pajtim me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, *proprio motu*, Trupi Gjykses mund të zgjasë ose të shkurtojë afatet e përcaktuara prej Rregullores.

3. Në pajtim me rregullën 76 të Rregullores, përgjigja ndaj një mocioni dorëzohet brenda dhjetë (10) ditësh, kurse kundërpërgjigja ndaj përgjigjes dorëzohet brenda pesë (5) ditësh prej dorëzimit të përgjigjes.

III. DISKUTIMI

4. Duke marrë parasysh natyrën shfajësuese të përmbledhjes së propozuar, nëse Mbrojtja dëshiron t’i përgjigjet Kërkesës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron

¹ KSC-BC-2020-07, F00061, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 29 tetor 2020, publik.

² KSC-BC-2020-07, F00252/RED, Prokurori i Specializuar, *Versioni i Redaktuar Konfidencial i ‘Njoftimit dhe Kërkesës së Prokurorisë për Dorëzimin e Përmbledhjes’*, 5 korrik 2021, konfidencial.

që ata ta bëjnë këtë deri në orën 16:00 të datës 8 korrik 2021. Nuk pranohen kundërpërgjigje.

IV. VENDIM

5. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

URDHËRON që përgjigjet ndaj Kërkesës, nëse do të ketë, të dorëzohen deri në orën **16:00, të enjten më 8 korrik 2021.**

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E martë, 6 korrik 2021

Hagë, Holandë.